

VENDIM
Nr. 206, datë 10.8.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 116, DATË 24.5.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ‘BLUE 1’, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/1-1 prot., datë 5.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin nr. 116, datë 24.5.2022 mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV BLUE 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, licenoi shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW. Në pikën 2, të këtij vendimi, është përcaktuar detyrimi që shoqëria të depozitojë në ERE certifikatat e regjistrimit të pronësisë për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, përpara vënies në operim të veprës.

- Me shkresën nr. 123/15 prot., datë 30.5.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimarrje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 123/16, datë 6.7.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 116/2022.

- Me plotësimin e kushtit, pikat 2 dhe 4, e vendimit nr. 116/2022, shfuqizohen.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikat 2 dhe 4 të vendimit nr. 116, datë 24.5.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti